



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1158/4 prot.

Datë 16.06.2022

V E N D I M

Nr. 565/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eral” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur – Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me Nr. REF-25878-04-20-2022, me objekt “Shërbim i Akomodimit të Personelit Turk”, me fond limit 32 247 180 (tridhjet e dy million e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Haxhi Shahu” PF në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Eral” SHPK
Sheshi “Nënë Tereza”, Rruga “Jakov Xoxa”, Fier,

“Haxhi Shahu” PF
Rruga nacionale Fier Tiranë, km 3, Mbrostar, Fier

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal "Memorial" Fier
Qender, Afrimi i Ri, Rruga "Daullas Greçalli" Nr 17,
Daullas, Fier, Albania

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
- I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

- II.1. Në datën 21.04.2022, është publikuar në SPE procedura e prokurimit "E hapur – Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj", me Nr. REF-25878-04-20-2022, me objekt "Shërbim i Akomodimit të Personelit Turk", me fond limit 32 247 180 (tridhjet e dy million e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e

tetëdhjet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

II.2. Në datën 19.05.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi rezultatin e vlerësimit nga KVO të ofertave të paraqitura dhe klasifikimin e tyre, si më poshtë vijon:

- | | | |
|--------------------|--------------------|---------------|
| 1. “ERAL” SHPK | 17,483,800.00 lekë | Skualifikuar; |
| 2. “HAXHI SHAHU”PF | 32,239,200.00lekë | Skualifikuar; |

II.4. Në datën 27.05.2022 është publikuar **njoftimi i anulimit** në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 69, më datë 30.05.2022.

II.5. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “ERAL” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, operatori ekonomik:

- *I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.*
- *NUK plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.*
- *I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.*
- *NUK plotëson kriteret e vecanta / kapacitetin teknik për kualifikim.*
- *NUK i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se OFERTA NUK PËRMBAN të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit DST dhe shtojcës përkatëse për ndryshime në DST, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-së, në mbështetje të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 80, pika 4, udhëzimin nr. 03, datë 09.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 07, datë 13.09.2017, udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 ‘Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara dhe shtojcës përkatëse për ndryshime në DST të ngarkuara në SPE për këtë procedurë prokurimi, u konstatua se oferta operatorit ekonomik ERAL SHPK , nuk është në përputhje me kriteret e vendosura në DST duke e konsideruar ofertë të pavlefshme. Konkretisht:

Në DST për këtë procedurë prokurimi në kriteret e veçanta për kualifikim janë kërkuar:

Kriter 2.1.1 : Licencën përkatëse të lëshuar nga Organi kompetent. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që është paraqitur një dokument i cili nuk është as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kriter 2.1.2 : Certifikata e klasifikimit ku përcaktohet kategoria dhe niveli përkatës i strukturës akomoduese , me afat vlefshmërie brenda afatit të ekzekutimit të kësaj kontrate. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që është paraqitur një dokument i cili nuk është as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kriteri 3.3.2: Operatori Ekonomik të ketë të punësuar të paktën 5 (pesë) të punësuar si: pastrues, kuzhinier, mirëmbjatës ose ekuivalente. Për këtë të paraqiten listëpagesat e punonjësve për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhillimit të procedurës së prokurimit si dhe deklaratë e Operatorit Ekonomik. Gjithashtu për punonjës/punonjësit me pozicion "kuzhinier" të paraqitet dokumenti/dokumenta për aftësitë teknike profesionale si: shkolla profesionale për këtë fushë apo certifikata trajnimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që dëshmia e kuzhunierit nuk është paraqitur as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kriter 3.3.3 Vërtetimin që vërteton se OE plotëson kushtet higjieno sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që është paraqitur një dokument i cili nuk është as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kriter 3.3.5 Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 5 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal "Memorial" Fier. OE duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje që vërteton vendndodhjen e Operatorit Ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që certifikata e pronësisë nuk është paraqitur as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kriter 3.3.8 OE merr përsipër që në rast emergjence shëndetësore të ekipit turk të vëjë në dispozicion një automjet 4+1 për transportin e personelit mjekësor (mjek/inferimier) nga hoteli në Spitalin Rajonal "Memorial" Fier.

Për automjetin të paraqitet:

-Në rast se automjeti është në pronësi të OE të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronesisë, polica e sigurimit e vlefshme.

-Në rast se automjeti është me qera osë në përdorim të OE të paraqitet kontrata e qeramarrjes ose përdorimit si dhe dokumentat e pronarit të ligjshëm : leja e qarkullimit, certifikata e pronesisë, polica e sigurimit e vlefshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që polica e sigurimit dhe leja e qarkullimit nuk janë paraqitur as origjinal as fotokopje e noterizuar në bazë të kërkesave të përcaktuara shprehimisht në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit te Kriteret është parashikuar si më poshtë:

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Shtojca 5 Formulari I Specifikimeve Teknike

Në DST është kërkuar : Operatori ekonomik pjesëmarrës për arsye sigurie duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që Deklarta e paraqitur nga Operatori Ekonomik është se nuk do të mbyllë aktivitetin për personat e 3-të, por do të krijojë një ambient të veçantë me hyrje të dedikuar me privatësi absolute dhe siguri të plotë. Kjo deklaratë sipas Nenit 82 pika 2 e VKM nuk është e vlefshme.

Nenit 82 pika 2 e VKM : Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit

Për sa më sipër, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 82 pika 2 e VKM, dokumentave të tenderit të miratuara në kriteret e veçanta për kualifikim pika 2.1.1, pika 2.1.2, pika 3.3.2, pika 3.3.3, pika 3.3.5, pika 3.3.8”Kapacitetin teknik” dhe shtojcen 5 “Formulari i specifikimeve teknike, u konstatua se oferta operatorit ekonomik ERAL SHPK për këtë procedurë prokurimi, nuk është në përputhje me kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura në DST, duke e konsideruar ofertë të pavlefshme.

II.5.1. Në datën 31.05.2022, operatori ekonomik “ERAL” SHPK ka paraqitur ankesë me nr. 1158 prot., datë 31.05.2022 njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1158/2 prot., datë 31.05.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ERAL” SHPK.

II.5.3. Nëpërmjet shkresës nr. 871/4 prot., datë 03.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1158/3 prot., datë 06.06.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ERAL” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, **duke e refuzuar atë**.

II.6. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “HAXHI SHAHU” PF për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, operatori ekonomik:

- *I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.*
- *I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.*
- *I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.*
- *NUK plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin teknik për kualifikim.*
- *I plotëson specifikimet teknike për kualifikim.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se OFERTA NUK PËRMBAN të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit DST dhe shtojcës përkatëse për ndryshime në DST, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-së, në mbështetje të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 80, pika 4, udhëzimin nr. 03, date 09.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 07, date 13.09.2017, udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 ‘Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara dhe shtojces përkatëse për ndryshime në DST të ngarkuara në SPE për këtë procedurë prokurimi, u konstatua se oferta operatorit

ekonomik HAXHI SHAHU, nuk është në perputhje me kriteret e vendosura në DST duke e konsideruar ofertë të pavlefshme. Konkretisht:

Në DST për këtë procedurë prokurimi në kriteret e veçanta për kualifikim janë kërkuar: Kriteri 3.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se 12 000 000 lekë (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës).

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që është paraqitur vetëm një vërtetim për përmbushje me sukses të detyrimeve kontraktuale, në të cilën nuk është përcaktuar as vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kriter 3.3.6 OE të ketë të punësuar një punonjës “përkthyes” të gjuhës turke. Për këtë të paraqitet kontratë pune me OE pjesëmarrës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur një kontratë pune të lidhur sipas Kodit të Punës me përkthyesin. Është paraqitur një Marrëveshje Shërbimi me kohë të pjesshme e cila është lidhur në datën 02.04.2022 por që realisht punonjësi nuk figuron i deklaruar në listpagesa e Sigurimeve Shoqërore për muajin prill. Do të thotë kontrata e paraqitur është fiktive. Gjithashtu dëshmia e përkthyesit nuk është as origjinale, as fotokopje e noterizuar. Nuk është paraqitur as dokument identifikimi i përkthyesit, i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës së punës.

Kriter 3.3.8 OE merr përsipër që në rast emergjence shëndetësore të ekipit turk të vëjë në dispozicion një automjet 4+1 për transportin e personelit mjekësor (mjek/infermier) nga hoteli në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.

Për automjetin të paraqitet:

-Në rast se automjeti është në pronësi të OE të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronesisë, policia e sigurimit e vlefshme.

-Në rast se automjeti është me qera osë në përdorim të OE të paraqitet kontrata e qeramarrjes ose përdorimit si dhe dokumentat e pronarit të ligjshëm : leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, polica e sigurimit e vlefshme. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që për mjetin AA620 GE dokumentat nuk janë as origjinal as fotokopje e noterizuar, ndërsa për mjetin AB934DM nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së automjetit.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit të Kriteret është parashikuar si më poshtë:

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Neni 82 pika 2 e VKM : Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 pika 2 e VKM, dokumentave të tenderit të miratuara në kriteret e veçanta për kualifikim pika 3.3.1, pika 3.3.6, pika 3.3.8 “Kapacitetin teknik”, u konstatua se oferta operatorit ekonomik HAXHI SHAHU për këtë procedurë prokurimi; nuk është në përputhje me kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura në DST, duke e konsideruar ofertë të pavlefshme.

II.6.1. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 02.06.2022, operatori ekonomik “HAXHI SHAHU” PF ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1176/2 prot., datë 03.06.2022 me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “HAXHI SHAHU” PF.

II.6.3. Me shkresën nr. 858/5 prot., datë 07.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1176/3 prot., datë 08.06.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “HAXHI SHAHU” PF, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën **është vendosur pranimi i të gjitha pikave të ankesës** së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar ndër të tjera si më poshtë:

- 1. Komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon se, pasi mori informacion nga Drejtoria e Financës e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues bashkëlidhur ankesës, gjykon se, vlera e shërbimeve të ngjashme të mëparshme të realizuar gjatë vitit 2021 (pra gjatë tre viteve të fundit) është 35,176,915 lekë. Pra jo më e ulët se 40% (12,000,000 lekë) e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi. Pra ky operator ekonomik e ka përmbushur kriterin për shërbimin e ngjashëm të mëparshëm të kryer gjatë tre viteve të fundit dhe në përputhje me vlerën e kërkuar.*
- 2. Arsyetohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, konstatimi i operatorit ekonomik konsiderohet i drejtë pasi në dokumentat standarde të tenderit, njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar kushtin që kontrata me punëmarrësin përkthyes të gjuhës turke të jenë nënshkruar para noterit. Është paraqitur një marrëveshje mes palëve në cilësinë e punëmarrësit dhe të punëdhënësit që në përmbajtje janë reflektuar elementët thelbësor të një kontrate individuale pune me kohë të pjesshme. Në zbatim të Kodit të Punë së Republikës së Shqipërisë, neni 14 i tij çdo punëdhënës ka të drejtë të punësojë edhe punëmarrës me kohë të pjesshme të cilët gëzojnë të njëjtat të drejta si punëmarrës me kohë të plotë. Referuar listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e muajit maj 2022 të operatorit ekonomik ankimues rezulton se punëmarrësi Z. J. N., me pozicion përkthyes është paguar për muajin prill 2022 në përputhje me aktmarrëveshjen/kontratën e punës sipas të cilës vërtetohet se marrëdhënia e punës mes palëve ka lindur më datë 02.04.2022 kurse data e zhvillimit të tenderit ka qënë data 19.05.2022. Pas verifikimit të dokumentave të ngarkuar në sistemin elektronik nga operator ekonomik rezulton se janë ngarkuar karta e identitetit dhe dëshmi të gjuhës turke. Pra nuk mungojnë këto dokumenta.*
- 3. Arsyetohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për përmbushjen e këtij kriteri (3.3.8) mjafton që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin dokumenta vetëm të një automjeti të caktuar. Pra me paraqitjen e dokumentave origjinale të mjetit me targa AB 934 DM ky kriter konsiderohet i plotësuar pavarësisht se nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së mjetit. “Leja e qarkullimit” në emër të administratorit të operatorit ekonomik ankimues e paraqitur në sistemin elektronik e përmbush kriterin për pronësinë e një automjeti në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës. Në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë neni 92 e tij përcaktohet se: 1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. 2. Degët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor marrin masa për regjistrimin dhe lëshojnë lejen e qarkullimit ndaj atij që vërteton se është pronar i mjetit, duke treguar, kur duhet, edhe gjeneralitetet e shfrytëzuesit ose të qiramarrësit me të drejtë blerjeje ose të shitësit me marrëveshje me të drejtë rikthimi, kur nuk paguhen këstet, siç është treguar në nenin 90. 3. Pra, me paraqitjen e dokumentit “Leja e qarkullimi” është përmbushur kriteri sipas të cilit ky operator ekonomik ka në*

pronësi një mjet. Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi pranimin plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik “Haxhi Shahu” PF për procedurën e prokurimit”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ERAL” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *“Shtojca 5, Formulari i Specifikimeve Teknike Në DST është kërkuar : Operatori ekonomik pjesëmarrës për arsye sigurie duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi rezulton që Deklarata e paraqitur nga Operatori Ekonomik është se nuk do të mbyllë aktivitetin për personat e 3-të, por do të krijojë një ambient të veçantë me hyrje të dedikuar me privatësi absolute dhe siguri të plotë. Kjo deklaratë sipas Nenit 82 pika 2 e VKM nuk është e vlefshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës për arsye sigurie duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ERAL” SHPK, në përmbushje të tij sa më sipër, ka dorëzuar:

-Deklaratë datë 19.05.2022 nga Administratori Z. E. S., ku ndër të tjera ka cilësuar së: *“Marrim përsipër akomodimin në ambient të veçantë me hyrje të dedikuar brenda strukturës dhe me parkim të rrethuar me roje dhe me sistem kamera. Struktura e hotelit dhe kushtet teknike krijojnë mundësinë e privatësisë dhe sigurisë absolute të personelit turk”.*

III.1.3. Në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 41, pika 2, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues për arsye sigurie duhet të marrin përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës. Ky specifikim teknik është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal

“Memorial” në Fier. Në këto kushte çdo ofertues pjesëmarës i interesuar në plotësim të specifikimit teknik të përcaktuar në dokumentet e tenderit, duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës, e cila është marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i saj. Referuar shqyrtimit të dokumenteve të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se operatori ekonomik ankimues “ERAL “ SHPK ka dorëzuar për plotësimin e këtij specifikimi teknik, Deklaratë datë 19.05.2022 nga Administratori Z. E. S., ku ndër të tjera ka cilësuar së: “*Marrim përsipër akomodimin në ambjent të veçantë me hyrje të dedikuar brenda strukturës dhe me parkim të rrethuar me roje dhe me sistem kamera. Struktura e hotelit dhe kushtet teknike krijojnë mundësinë e privatësisë dhe sigurisë absolute të personelit turk*”. Komisioni konstaton se, për plotësimin e specifikimit teknik të sipërcituar, operatori ekonomik ankimues duhet të deklarojë që bie dakort dhe pohon që për arsye sigurie duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës, gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Pretendimi i operatorit ekonomik që për plotësimin e këtij specifikimi teknik me anë të deklaratës së ngarkuar në SPE sipas së cilës, do të akomodojë në ambjent të veçantë me hyrje të dedikuar brenda strukturës dhe me parkim të rrethuar me roje dhe me sistem kamera si dhe struktura e hotelit, kushtet teknike krijojnë mundësinë e privatësisë dhe sigurisë absolute të personelit turk, nuk përmbush plotësimin e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, bazuar në faktin që në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, për arsye sigurie duhet të marrë përsipër mbylljen e aktivitetit brenda rrethimit dhe nuk duhet të lejojë klientë të tretë brenda ambienteve të tij përveç personelit të hotelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës, ndërkohë që nga operatori ekonomik ankimues është paraqitur një deklaratë ku nuk pohon dhe nuk bie dakort në lidhje me këtë specifikim teknik, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues “ERAL” SHPK nuk përmbush specifikimin teknik në shtojcën 5, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE.

Gjithashtu, KPP sqaron, se në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, për sa i përket dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në

dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së i cili paashikon se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

2. *Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

3. *Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës”.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “ERAL” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “HAXHI SHAHU” PF mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Me shkresën nr. 858/5 prot., datë 07.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1176/3 prot., datë 08.06.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “HAXHI SHAHU” PF, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën **është vendosur pranimi i të gjitha pikave të ankesës** së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Komisioni i shqyrtimit të ankesave arsyeton:

- 1. Komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon se, pasi mori informacion nga Drejtoria e Financës e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues bashkëlidhur ankesës, gjykon se, vlera e shërbimeve të ngjashme të mëparshme të realizuar gjatë vitit 2021 (pra gjatë tre viteve të fundit) është 35,176,915 lekë. Pra jo më e ulët se 40% (12,000,000 lekë) e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi. Pra ky operator ekonomik e ka përmbushur kriterin për shërbimin e ngjashëm të mëparshëm të kryer gjatë tre viteve të fundit dhe në përputhje me vlerën e kërkuar.*
- 2. Arsyetohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, konstatimi i operatorit ekonomik konsiderohet i drejtë pasi në dokumentat standarde të tenderit, njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar kushtin që kontrata me punëmarrësin përkthyes të gjuhës turke të jenë nënshkruar para noterit. Është paraqitur një marrëveshje mes palëve në cilësinë e punëmarrësit dhe të punëdhënësit që në përmbajtje janë reflektuar elementët thelbësor të një kontrate individuale pune me kohë të pjesshme. Në zbatim të Kodit të Punë së Republikës së Shqipërisë, neni 14 i tij çdo punëdhënës ka të drejtë të punësojë edhe punëmarrës me kohë të pjesshme të cilët gëzojnë të njëjtat të drejta si punëmarrës me kohë të plotë. Referuar listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e muajit maj 2022 të operatorit ekonomik ankimues rezulton se punëmarrësi Z. J. N., me pozicion përkthyes është paguar për muajin prill 2022 në përputhje me aktmarrëveshjen/kontratën e punës sipas të cilës vërtetohet se marrëdhënia e punës mes palëve ka lindur më datë 02.04.2022 kurse data e zhvillimit të tenderit ka qënë data 19.05.2022. Pas verifikimit të dokumentave të ngarkuar në sistemin elektronik nga operatori ekonomik rezulton se janë ngarkuar karta e identitetit dhe dëshmi të gjuhës turke. Pra nuk mungojnë këto dokumenta.*
- 3. Arsyetohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për përmbushjen e këtij kriteri (3.3.8) mjafton që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin dokumenta vetëm të një automjeti të caktuar. Pra me paraqitjen e dokumentave origjinale të mjetit me targa AB 934 DM ky kriter konsiderohet i plotësuar pavarësisht se nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së mjetit. “Leja e qarkullimit” në emër të administratorit të operatorit ekonomik ankimues e paraqitur në sistemin elektronik e përmbush kriterin për pronësinë e një automjeti në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës. Në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë neni 92 e tij përcaktohet se: 1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. 2. Degët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor marrin masa për regjistrimin dhe lëshojnë lejen e qarkullimit ndaj atij që vërteton se është pronar i mjetit, duke treguar, kur duhet, edhe gjeneralitetet e shfrytëzuesit ose të qiramarrësit me të drejtë blerjeje ose të shitësit me marrëveshje me të drejtë rikthimi, kur nuk paguhen këstet, siç është treguar në nenin 90. 3. Pra, me paraqitjen e dokumentit “Leja e qarkullimi” është përmbushur kriteri sipas të cilit ky operator ekonomik ka në pronësi një mjet. **Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi***

pranimin plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik “Haxhi Shahu” PF për procedurën e prokurimit”.

II.3.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur **pranimin e plotë të ankesës**, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “HAXHI SHAHU” PF, për procedurën e prokurimit “*E hapur – Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj*”, me Nr. REF-25878-04-20-2022, me objekt “Shërbim i Akomodimit të Personelit Turk”, me fond limit 32 247 180 (tridhjet e dy million e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ERAL” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “HAXHI SHAHU” PF.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik ankimues “ERAL” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj
	Kryetar	
	Jonaid Myzyri	